



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 12, datë 27.02.2019

PËR

**“MIRATIMIN E LEJEVE TË ZHVILLIMIT/ NDËRTIMIT NGA AUTORITETET E
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, NË NJËSITË QË I PËRKASIN SISTEMEVE
URBAN (UB), BUJQËSOR (B) DHE NATYROR(N)”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Vendimin Nr. 22, datë 12.01.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 283, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore”, i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë:
 - a) *Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;*
 - b) *Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.*
2. Ndërtimi i objekteve dhe strukturave, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, duhet të respektojë legjislacionin në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj. sipas territorit specifik.

3. Ndërtimi i objekteve dhe strukturave, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, duhet të lejohet me kusht respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural përkatës, si dhe mosçënimin e infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse, sipas dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, apo nga legjislacioni sektorial në fuqi, strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë 2 kate me nënçati.

5. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme, në struktura në funksion të agroturizmit është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij vendimi dhe në çdo rast duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Shtesat në strukturat ekzistuese duhet të jenë në respektim të pikës 4 të këtij vendimi.

6. Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pas:

- a. marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
- b. njoftimit të Këshilli Kombëtar të Territorit.



7. Pas ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe strukturave të agroturizmit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të tyre në vijimësi.

8. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij Vendimi.

9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
BLEDI ÇUÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

